



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 20 maj 2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa dhe Naim Fetahu.

Munguan: Valdete Bajrami dhe Duda Balje.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision, Saranda Kaçiu, praktikante, Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Sanije Berisha- OSBE, Qendresa Mulaj - ZAP, Artan Venhari - ZAP, Emine Fazliu – ZAP dhe Faruk Rrahmani – ZAP.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datën 7.4.2015 dhe 27.4.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës, për vitin 2014;
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;
6. Të ndryshme;

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi që aprovohet rendi i ditës me ndryshime, me ç'rast pika 4 e rendit të ditës u hoq nga diskutimi.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 7.4.2015 dhe 27.4.2015;

Kryetari paraqiti para deputetëve procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 7.4.2015 dhe 27.4.2015, dhe pyeti nëse ka vërejtje apo sugjerime për ndryshim.

Pasi të gjithë deputetët u pajtuan, njëzëri u miratuan procesverbalet.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014;

Kryetari theksoi se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në bazë të Ligjit mbi auditimin e jashtëm obligohet që të dorëzojë raport financiar dhe atë të performancës në Kuvendin e Republikës së Kosovës për të qartësuar aspektin financiar dhe atë organizativ të ZAP-it për çdo vit fiskal. Raporti i performancës i ZAP-it për vitin 2014, i dorëzuar në Kuvend nuk përmban pasqyrat

vjetore të audituara, për arsye se Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të gjejë një kompani të jashtme të auditimit për auditimin e pasqyrave vjetore financiare për ZAP-in, ashtu siç kërkohet me Ligjin mbi auditorin e jashtëm.

Artan Venhari – Së pari, këtij raporti ende i mungon pjesa e auditimi të pasqyrave financiare nga një auditor i jashtëm dhe kjo është arsye pse është në këtë format dhe jemi në pritje të zgjedhjes së auditorit nga ana e Kuvendit. Pra, ky raport dëshmon performancën tonë në sezonin e auditimit për vitin 2013-2014.

Raporti i performancës së ZAP-it përfshinë sezonin e auditimit e jo vitin fiskal. Për këtë sezon ne kemi arritur t'i dorëzojmë në Kuvend 102 raporte të auditimit, ku 6 prej tyre janë kryer nga operatorët ekonomikë privatë.

Po ashtu, ZAP-i ka arritur që të krijojë të hyra vetjake nga auditimet e bëra, të projekteve të jashtme si DANIDA, DAMAD etj.

Kështu, ZAP-i ka pasur sfida e njëra nga sfidat ka qene mungesa e llogaridhënies për Kuvendin për shkak të shpërbërjes së tij në pjesën e parë të vitit 2014.

Po ashtu, skadimi i mandatit të Auditorit të Përgjithshëm. Ligji mbi auditimin e jashtëm, i cili nuk është aprovuar në fund të legjislaturës së katërt, pastaj vazhdimi i bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Jashtëm nga Mbretëria e Bashkuar.

Besnik Bislimi pyeti, pse rekomandimet e dhëna për komunat nga ZAP-i më se 60% e tyre nuk janë adresuar, si e shpjegohet kjo?

Po ashtu, numri i stafit që lëviz është i vogël, cili është motivi që auditorët nuk lëvizin nga ZAP-i?

Bashkëpunimi me sindikatën e ZAP-it, si qëndrojnë raportet në mes menaxhmentit të ZAP-it dhe sindikatës?

Artan Venhari tha se numri i stafit profesional në komuna është i mangët, për dallim me ato të nivelit qendror, po ashtu edhe mungesa e kryeshefit të ekzekutivit në komuna po paraqet problem në adresimin e rekomandimeve tona. Është e vërtetë se nuk ka lëvizje të stafit të auditorëve, mirëpo, nuk ka mundësi më të mira për tu zhvilluar me tepër profesionalisht, ndërsa marrëdhëniet me sindikatën janë të mira në kontekst të dialogut, por jo në kontekst të ndërhyrjes në drejtimin e ZAP-it.

Ali Sadriu theksoi se respektimi i sindikatës duhet të bëhet deri në një nivel, por jo në dhënien e kompetencave për drejtim të institucionit. Po ashtu, Kuvendi në vitin e kaluar ka shqyrtuar një numër të vogël të raporteve të auditimit, edhe mungesa e trajtimit të komunave është bërë me një dëgjim publik me të gjitha komunat.

KMFP-ja e ka të pamundur t'i shqyrtojë të gjitha raportet e auditimit për shkak të numrit të madh të tyre.

Artan Venhari tha se nëse shikohet raporti i performancës së ZAP-it dhe plani për të ardhmen , thuhet se numri i auditimeve rritet nga 102 në 118, kuptohet këtu shtohet numri i auditimeve të performancës nga 9 në 19.

Synavere Rysha theksoi se bazuar në raportin e performancës, ku thuhet se në sezonin e auditimit është arritur një performancë e mirë, duhet të ketë edhe të dhëna krahasuese se sipas këtij plani sa janë realizuar objektivat, fjala vjen numri i auditimeve. Dua të pyes lidhur me aktet nënligjore që i shfrytëzon ZAP-i, apo janë të hartuara nga vetë ZAP-i?

Artan Venhari- Sa i përket akteve nënligjore, ZAP-i ka shumë manuale, udhëzues dhe doracakë që përdorën nga auditorët me rastin e auditimeve të institucioneve të ndryshme dhe ne do t'ju sigurojmë një kopje të tyre nëse për këtë keni nevojë . Gjithashtu, vonesa në hartimin e ligjit të ri për ZAP-in, nuk ka paraqitur problem në funksionimin e kësaj zyre. Bisedat me ministrin e MAP-it janë gati në arritjen e një marrëveshjeje për vendosjen e ZAP-it në objektin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, vetëm se hapësira për vendosje është vetëm për 140 persona.

Meqenëse nuk pati të interesuar për të diskutuar nga të pranishmit, kryetari konstatoi se raporti i performancës së ZAP-it për vitin 2014, është shqyrtuar në komision dhe si e tillë nuk ka nevojë të adresohet për seancë plenare.

Përfundim

Aprovohet raporti i performancës së ZAP-it për vitin 2014 dhe i njëjti nuk do të adresohet në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës, për vitin 2014;

Kryetari i njoftoi deputetët se për shkak të kohës së shkurtër, nuk është ftuar ministri i Financave dhe drejtori i NJQHAB, për të arsyetuar raportin, kështu që kjo pikë e rendit të ditës do të diskutohet në mbledhjet e radhës së KMFP.

Përfundim

Raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014, do të shqyrtohet në takimin e radhës së KMFP.

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;

Kryetari- Në këtë pikë kemi të bëjmë me Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. Të gjeturat nga ky raport mund ti sqarojnë më konkretisht përfaqësuesit e ZAP-it.

Emine Fazliu theksoi se ZAP-i ka hartuar raportin Auditimit për KPM-në për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe se opinioni i dhënë për këtë raport është i pamodifikuar, që nënkupton se PVF-ja paraqesin një pamje të drejtë dhe reale. Të gjeturat e auditimit janë dhënë për 5 fusha, të cilat janë të dhëna në raport. Megjithatë menaxhmenti i KPM-së është pajtuar që të merret seriozisht me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP-i si dhe është në proces të adresimeve të dhëna nga ZAP-i për KMP-në nga viti i kaluar. KPM-ja e ka edhe auditorin e brendshëm.

Ali Sadriu tha se meqenëse raporti i punës së KPM-së është aprovuar ditë më parë në seancë plenare pa PVF-të të audituara dhe pa u shqyrtuar në KMFP, prandaj çfarëdo diskutimi në këtë pikë është i panevojshëm.

Synavere Rysha theksoi se është mirë para se të shqyrtohen raportet vjetore të punës së agjencive të pavarura, në seancë plenare të jetë edhe raporti i PVF-së të audituara për këto institucione.

Pasi që nuk pati të interesuar për të diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës, kryetari e mbylli diskutimin me këtë përfundim:

Përfundim

Aprovohet raporti i PVF të KPM-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 dhe i njëjti nuk do të adresohet në seancë plenare.

6.Të ndryshme;

Kryetari Besnik Bislimi, ua përkujtoi se koha për raportin kthyes për ministrin e Shëndetësisë është afruar prej 3 muajve dhe theksoi se në takimet e radhës në KMF duhet të diskutohen këto rekomandime ose të bëhen pyetje parlamentare për ministrin e Shëndetësisë, se a janë adresuar këto rekomandime. Ai i njoftoi deputetët se GIZ-i ka angazhuar një zyrtarë për të mbështetur Komisionin dhe me këtë njoftim edhe e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi